

VENDIM
Nr. 622, datë 1.11.2017

**PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE DHE TË MASËS SË PËRFITIMIT TË
NDIHMËS FINANCIARE NË RAST VDEKJEJE, SËMUNDJEJE OSE FATKEQËSIE
PËR PUNONJËSIT CIVILË TË AGJENCISË SË INTELIGJENCËS DHE SIGURISË
SË MBROJTJES**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 58, të ligjit nr. 65/2014, “Për Agjencinë e Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes”, me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Punonjësi civil i Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes (AISM) ose familja e tij, në rast vdekjeje, sëmundjeje të rëndë dhe për një kohë të gjatë ose dëmtimesh të rënda të pronës, si rezultat i një fatkeqësie natyrore, përfiton ndihmë financiare të menjëhershme, si më poshtë vijon:

- a) 6 paga mujore të muajit të fundit, kur vdes;
- b) 4 paga mujore të muajit të fundit, kur sëmuret rëndë dhe për një kohë të gjatë, e vërtetuar me raport mjekësor;
- c) 3 paga mujore të muajit të fundit, kur njëri nga familjarët në ngarkim të tij vdes ose sëmuret rëndë dhe për një kohë të gjatë, e vërtetuar me raport mjekësor;
- ç) 4 paga mujore të muajit të fundit, kur pëson dëmtime të rënda të pronës, si rezultat i një fatkeqësie natyrore.

2. Kur punonjësi civil në detyrë i AISM-së vdes, kjo agjenci organizon ceremoninë e rastit dhe përballon shpenzimet e varrimit, sipas dokumenteve që justifikojnë shpenzimet.

3. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga fondi i veçantë në përputhje me aktet ligjore në fuqi.

4. Procedura dhe dokumentacioni i nevojshëm për dhënien e ndihmës financiare, në zbatim të këtij vendimi, përcaktohen me udhëzim të ministrit të Mbrojtjes.

5. Ngarkohet ministri i Mbrojtjes për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama